



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË DRAGASHIT PËR VITIN 2020

Prishtinë, korrik 2021

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

1	Opinioni i Auditimit.....	3
2	Gjetjet dhe rekomandimet.....	7
3	Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit.....	15
4	Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	18
	Shtojca I: Letër konfirmimi.....	23
	Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesët e tjera të Raportit të Auditimit	24

Për: z. Shaban Shabani, Kryetar i Komunës së Dragashit

Adresa: Sheshi i Dëshmorëve, 22000, Dragash

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Dragashit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet¹.

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Dragashit, të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Dragashit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit *‘Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare’*. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

¹ Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik

² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar.

Konkluzioni i auditimit për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar gjithashtu pajtueshmërinë e menaxhmentit të Komunës së Dragashit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të komunës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Theksimi i çështjes

Për vëmendjen tuaj, dëshirojmë të theksojmë faktin se Komuna kishte bërë pagesa nga kategoria e Investimeve kapitale në shumën prej 85,989€. Kjo kishte ndodhur për arsyen se me rastin e aprovimit të Ligjit për ndarjet buxhetore të vitit 2020, këto shpenzime ishin planifikuar dhe ekzekutuar në kategori jo adekuate ekonomike dhe kanë rezultuar me keq klasifikim të shpenzimeve, duke mbivlerësuar shpenzimet në kategorinë e Investimeve kapitale apo dhe duke i nënvlerësuar shpenzimet e mallrave dhe shërbimeve për të njëjtën shumë.

Duke qenë se çështja në fjalë është mjaft e përhapur në shumë organizata buxhetore dhe po përsëritet për vite me radhë, ajo do të trajtohet më hollësisht në Raportin e auditimit të Pasqyrave Financiare të Qeverisë, ku edhe do të jepen rekomandimet përkatëse për zgjidhje afatgjatë.

Në lidhje me këtë çështje, për arsyen e lartpërmendur, nuk është modifikuar opinionimi i auditimit.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës së Dragashit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës së Dragashit është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme,

të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Dragashit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Dragashit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë, dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t gjithmonë do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Dragashit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqpërfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.

³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mospajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqpërfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm Komunës së Dragashit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.


Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit tonë, ne kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve (siç janë paraqitur në Grafikon 1, më poshtë) dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Grafiku 1. Lloji i gjetjeve sipas kategorive ekonomike



Ne po ashtu, kemi rishikuar statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe kemi vlerësuar nivelin e zbatimit të tyre. [Për detaje shih kapitullin 4]

2.1 Gjetjet për çështjet e menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga komuna për vitin 2020 ishin në vlerë 253,217€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj.

Çështja B1 - Parregullsi në dhënien me qira të pronave komunale

Gjetja Sipas nenit 1 pika 1 të Ligjit nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale, cek “Ky ligj ka për qëllim të siguroj shfrytëzimin efektiv të pronës së paluajtshme të komunës për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, rritjen e vlerës së pronës së paluajtshme të komunës dhe përmbushjes së interesit të përgjithshëm kurse neni 8 pika 1 ”Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës bëhet përmes procedurave të 1.1 ankandit publik; 1.2 shprehjes së interesit; dhe 1.3 negociatave të kryetarit të komunës”.

Në regjistrin e Komunës së Dragashit figurojnë 109 prona/toka të cilat janë në shfrytëzim, toka është e komunes ndërsa objektet ishin ndërtuar nga shfrytëzuesit. Prej tyre 26 prona janë me kontrata para viteve 2006 dhe 77 prona tjera shfrytëzohen me kontrata të skaduara, që nga viti 2002 deri 2017. Edhe përkundër shkresave, njoftimeve të kohëpaskohshme dhe pajtimit të shfrytëzuesve për pagesën e borxhit, Komuna nuk ka ripërtërirë kontratat apo nuk ka kontraktime përmes procedurave.

Edhe përkundër rekomandimit nga viti i kaluar, kjo gjendje ende është duke vazhduar me kontrata të tilla si rezultat i mos ndërmarrjes së masave nga komuna.

Ndikimi Shfrytëzimi i pronave publike, pa kontrata valide mes komunës dhe shfrytëzuesve të pronës komunale mund t'i shkaktoj komunës humbje të konsiderueshme financiare, po ashtu humb mundësinë për të siguruar se prona publike në dispozicion të komunës menaxhohet si duhet.

Rekomandimi B1 Kryetari i komunës duhet të shtojë kontrollet lidhur me dhënien në shfrytëzim të pronës komunale duke vlerësuar të gjitha kontratat. Njëherit të sigurojë së dhënia e këtyre pronave në shfrytëzim bëhet sipas kërkesave të ligjit për shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

2.1.2 Mallrat dhe shërbimet

Buxheti final për mallra dhe shërbime si dhe shërbime komunale në vitin 2020 ishte 1,589,384€, prej tyre ishin shpenzuar 1,164,414€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shërbime kontraktuese tjera, furnizim për zyre, naftë për ngrohje qendrore, dru, mirëmbajtja e shkollave etj. Kemi testuar 28 mostra për teste substanciale si dhe të pajtueshmërisë në vlerë 438,617€.

Çështja A1 – Pranimi i mallit jo sipas kontratës

Gjetja Në kontratën e nënshkruar me dt 02.07.20219 për furnizim me dru për ngrohje dhe sharritja e tyre për nevojat e Komunës së Dragashit te neni 1, pika 1.7 përcakton që: Pranimi i mallit do të bëhet nga tre persona, Drejtori i shkollës dhe dy anëtarë me fletdërgesë të nënshkruar dhe vulosur nga komisioni.

Gjatë testimit të pagesave për furnizim me dru kemi vërejtur si në vijim:

- Te pagesa 6,500€ kemi vërejtur që ishin pranuar tri fletdërgesa në vlerë 270 metra dru mirëpo nuk ishin të nënshkuara nga tre anëtar por vetëm nga Drejtori i shkollës. Gjithashtu këto furnizime ishin bërë në muajin korrik të vitit 2019 ndërsa fatura dhe raporti i pranimit ishin të muajit prill 2020;
- Te pagesa 5,500 € kishte një raport të pranimit të komisionit i cili ishte nënshkruar nga tre anëtarë mirëpo jo në fletdërgesa gjatë pranimit siç kërkohet me kontratë; dhe
- Në pagesën tjetër në vlerë 4,500€ kemi vërejtur që tri fletdërgesa ishin të korrikut të vitit 2019 ndërsa fatura në vitin 2020. Edhe në këto fletdërgesa kishte pranime të cilat nuk ishin të pranuar nga tre anëtar të komisionit.

Kjo kishte ndodhur pasi komisioni në raportin e pranimit është nënshkruar me datën e faturës dhe jo në fletdërgesë gjatë pranimit të drunjëve.

Ndikimi Pranimi i mallrave në mungesë të plotë të anëtarëve të komisionit të pranimit siç është përcaktuar në kontratë rrit rrezikun që mallrat të mos jenë sipas sasisë dhe kushteve të kontratës.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurohet që pranimin i mallrave përkatësisht drunjëve bëhet sipas kushteve të kontratës dhe që asnjë pagesë të mos bëhet nëse pranimet nuk janë të nënshkuara nga tre anëtar të komisionit.

Çështja A2 – Hyrja në obligime pa zotim të mjeteve

Gjetja Rregulla financiare Nr.01/2013 përcakton që fillimisht duhet të bëhet kërkesa për blerje, më pas zotimi i mjeteve, të procedohet urdhër-blerja, pastaj të pranohet malli apo shërbimi, dhe pas pranimit të faturës të ekzekutohet pagesa.

Gjatë testimit në tri pagesa për furnizim me dru, kemi vërejtur që Komuna, përkatësisht shkollat kishin pranuar apo furnizuar dru në vlerë 34,000€, mirëpo kishin zotuar dhe paguar vetëm vlerën 15,000€. Diferenca prej 19,000€ tregon që Komuna ishte në obligime ndaj OE. Po ashtu për këto furnizime nuk kishte as faturë që të raportonte si obligim Komuna ndaj OE.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i menaxhimit jo të mirë të kontratës për furnizime me drunj.

Ndikimi Hyrja në obligime si rezultat i menaxhimit jo të mirë, pa siguruar fondet e nevojshme ka ndikuar në krijimin e obligimeve të cilat do të rëndojnë buxhetin e vitit pasues.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të siguroj se kërkesat dhe furnizimet bëhen vetëm pasi të jenë zotuar mjetet duke eliminuar hyrjen në obligime të paplanifikuara.

Çështja B2- Klasifikim jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja Sipas Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF “Mbi shpenzimin e parasë publike” shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël, po ashtu me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë.

Gjatë testimit të shpenzimeve kemi vërejtur se në një pagesë nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve në vlerë 9,458€, kemi vërejtur që natyra e shpenzimit i takonte kategorisë së investimeve kapitale. Kjo pagesë ishte kryer për renovimin dhe sanimin e oborrit të shkollës në Llopushnik.

Shkaku këtyre keq-klasifikimeve ishte mungesa e buxhetit në kategoritë përkatëse.

Ndikimi Raportimi apo klasifikimi jo i saktë i të dhënave në pasqyrat financiare shpie në keqkuptim të aktiviteteve financiare të Ministrisë, duke mbivlerësuar/nënvlerësuar kategoritë ekonomike.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë veprimet e nevojshme në mënyrë që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV në përputhje me planin kontabël.

2.1.3 Çështjet e përbashkëta për kategori të caktuara ekonomike

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me kategori ekonomike si psh: mallrat dhe shërbimet, si dhe investimet kapitale:

Çështja B3 – Shmangie e procedurave të hapura të prokurimit

Gjetja Pika 54.1 i Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik përcakton që “Autoriteti kontraktues mund ta përdor procedurën me vlerë minimale për çdo kontratë publike vlera e përllogaritur e të cilës është më pak se 1,000€. Me dhënien e porosive për blerje në lidhje me prokurimin me vlerë minimale, Autoriteti kontraktues do të sigurojë një konkurrim efektiv, transparencë dhe efektivitet të lartë të përdorimit të fondeve publike. Kontratat me vlera minimale që zhvillohen në Institucionet arsimore, person i autorizuar të nënshkruaj një kontratë është Drejtori i Institucionit Arsimor” dhe 54.2 “Në llogaritjen e vlerës së kontratës për përdorimin e procedurës së vlerës minimale, autoriteti kontraktues do t'i marrë parasysh vetëm një grup të mallrave, shërbimeve apo punëve të ngjashme, të cilat zakonisht prokurohen së bashku dhe të cilat nuk duhet të ndahen me qëllim të përdorimit të një procedure të tillë”.

Nga raporti i kontratave të nënshkruara për vitin 2020, komuna ngjashëm si në vitin e kaluar kishte nënshkruar 71 kontrata përmes procedurës me vlerë minimale me vlerë 62,508€. Gjatë auditimit kemi vërejtur që kishte kontrata për furnizime dhe shërbime të natyrës së njëjtë duke anashkaluar procedurat e hapura të tenderimit.

Shkaqet e realizimit të procedurave të ndara të prokurimit është mungesë e komunikimit të njërive kërkuese dhe prokurimit gjatë përgatitjes së planit për prokurim.

Ndikimi Praktika e tillë shton rrezikun e mos arritjes së vlerës për para dhe dëmtojnë transparencën, eliminojnë konkurrencën dhe vejnë në pikëpyetje cilësinë e shërbimeve dhe produkteve të pranuar.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të siguroj që bëhet një planifikim i hollësishëm dhe njësitë kërkuese duhet të vlerësojnë në mënyrë të drejtë kërkesat për prokurim.

2.1.4 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 36,362,407€, pasurive jokapitale është 261,740€, si dhe e stoqeve 531€. Kemi testuar 45 mostra për teste substanciale si dhe të pajtueshmërisë në vlerë 1,305,688€.

Çështja B4 – Mangësi në evidentimin e pasurisë

Gjetja Sipas Rregullores 02/2013 “Çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Regjistri duhet të mbahet ndaras për çdo pasuri dhe në formë të agreguar sipas kategorive të klasifikuara në bazë të planit kontabël.

Gjatë testimit të pasurive nën 1,000€, kemi vërejtur që vlera e pasurive e prezantuar në PFV ishte 261,740€. Megjithatë, edhe më tutje blerjet nga sektori i QKMF-së, Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Arsimit nuk regjistrohen në softuerin e e-pasurisë dhe nuk kanë vlerë të stokut.

Përkundër rekomandimit nga viti i kaluar kjo çështje vazhdon të mbetet e njëjtë, komuna ende nuk kishte funksionalizuar kontrollet për regjistrimin e pasurive.

Ndikimi Mangësitë në regjistrimin e plotë të pasurisë, duke mos përfshirë të gjitha blerjet, vështirësojnë identifikimin e pasurive për të konfirmuar ekzistencën, prejardhjen dhe pronësinë e tyre. Kjo rezulton edhe me nënvlerësim të pasurive të prezantuara dhe shpalosura në PFV.

Rekomandimi B4 Kryetari duhet të siguroj se kërkesat në lidhje me regjistrimin dhe mirëmbajtjen e pasurive duhet të aplikohen në tërësi, përmes sistemit e-pasuria të evidentohen të gjitha hyrjet/daljet e pasurive të luajtshme (me vlera nën 1,000€) për të gjitha dikasteret komunale.

2.1.5 Të arkëtueshmet

OB-ja në PFV e vitit 2020 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 2,029,219€. Kjo vlerë përbehet nga tatimi në pronë 1,152,178€, taksa komunale në biznese 595,807€ si dhe shfrytëzimi i pronës komunale 281,234€.

Çështja B5- Menaxhim jo efikas i llogarive të arkëtueshme

Gjetja Komuna në PFV e vitit 2020 ka shpalosur llogari të arkëtueshme (LLA) në vlerë prej 2,029,219€. Kjo vlerë përbehet nga tatimi në pronë, taksa komunale në biznese dhe shfrytëzimi i pronës komunale.

Komuna nuk ka një plan për inkasimin e llogarive të arkëtueshme nga debitorët e saj. Si pasojë, të arkëtueshmet vazhdimisht po rriten duke shkaktuar vështirësi në inkasimin e tyre. Në vitin 2020 kemi një rritje prej 101,273€ apo 5% krahasuar me vitin paraprak (1,927,946€). Në këtë rritje ndikimi më i madh ishte nga tatimi në pronë.

Për të arkëtueshmet nga tatimi në pronë, Komuna pasi kishte shpërndarë faturat janë përzgjedhur debitorët që kanë borxhe mbi 300€ dhe janë dërguar shkresat me flete pranime, pjesa më e madhe nuk kanë qenë në Kosovë dhe si të tilla kanë mbetur të papaguara.

Ndikimi Mungesa e mekanizmave dhe efikasitetit për inkasim të borxheve nga debitorët mund të shkaktoj probleme në përmbushjen e planit të shpenzimeve, ndërsa vjetërsia e tyre zvogëlon gjithnjë e më shumë gjasat që borxhet të inkasohen.

Rekomandimi B5 Kryetari duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika, rregullore dhe mekanizma tjerë me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e të arkëtueshmeve. Po ashtu, duhet shqyrtuar të gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj debitorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet.

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁴	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Burimet e fondeve	9,045,190	10,452,433	9,126,590	7,382,222	7,591,432
Grante Qeveritare – Buxheti	8,582,846	8,968,242	8,195,883	7,039,851	7,215,850
Financimi përmes huamarrjes	-	161,451	108,909	14,041	69,961
Të bartura nga viti i kaluar ⁵ –	-	832,368	704,644	204,378	158,748
Të hyrat vetanake ⁶	462,344	462,344	109,655	123,952	146,873
Donacionet e jashtme	-	28,029	7,500	-	-

Buxheti përfundimtar është më i lartë se buxheti fillestar për 1,407,243€. Kjo rritje është rezultat i rritjes prej grantit qeveritar 385,396€, huamarrjes 161,451€, të hyrave vetanake nga viti i kaluar 832,368€, dhe donacioneve 28,029€.

Në vitin 2020 Komuna e Dragashit ka shpenzuar 87% të buxhetit përfundimtar ose 9,126,590€, me një rritje prej 6% në krahasim me vitin 2019. Sidoqoftë, shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

⁴ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

⁵ Të hyrat vetjake të komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.


⁶ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

Tabela 2 – Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike - (në €)


Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	9,045,190	10,452,433	9,126,590	7,382,222	7,591,432
Pagat dhe mëditjet	4,586,095	4,711,011	4,709,414	4,458,302	4,469,699
Mallrat dhe Shërbimet	938,908	1,468,347	1,049,184	773,014	814,867
Komunalit	130,000	121,037	115,230	120,305	105,151
Subvencionet dhe Transferet	160,000	756,092	599,234	167,050	44,020
Investimet Kapitale	2,550,430	3,395,945	2,653,529	1,863,551	2,157,695
Rezervat	679,757	-	-	-	-

Grafiku 2. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike

Shpenzimet sipas kategorive ekonomike gjatë periudhës 2018-2020



Grafiku 3. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike në vitin 2020



Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Rritja e buxhetit të Pagave dhe Mëditjeve në raport me atë fillestar ishte 124,916€. Kjo rritje fillimisht ishte prej huamarrjes 57,960€, nga granti qeveritar 65,947€ si dhe nga donacionet për 1,010€. Shpenzimi ishte 100% e buxhetit në këtë kategori;
- Te kategoria e mallrave dhe shërbimeve buxheti final ishte rritur në raport me atë fillestar për vlerën 529,439€. Me rishikim të buxhetit është rritur 130,496€ ndërsa me vendime të Qeverisë për vlerën 398,943€. Në këtë kategori, shpenzimi ishte 71%;
- Buxheti përfundimtar i kategorisë së shërbimeve komunale ishte zvogëluar në raport me fillestar për vlerën 8,963€ me vendime të Qeverisë. Shpenzimi ishte 95% e buxhetit;
- Sa i përket buxhetit përfundimtar të subvencioneve dhe transfereve, në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për vlerën 596,092€ me vendim të qeverisë, prej të cilave nga granti qeveritar 530,454€ dhe nga të hyrat e vitit të kaluar 65,638€. Në këtë kategori shpenzimi ishte 79%; dhe
- Rritja në buxhetin e investimeve kapitale në raport me atë fillestar ishte për vlerën 845,515€. Kjo rritje ishte nga rishikimi buxhetor 105,942€ dhe vendimeve të qeverisë për vlerën 739,573€. Shpenzimet në këtë kategori ishin 78% e buxhetit.

Komuna për shpenzimet e ndodhura për menaxhimin e pandemisë COVID 19, kishte shpenzuar 746,197€. Prej tyre nga pagat dhe mëditjet 181,020€, mallrat dhe shërbimet 278,702€ si dhe nga subvencionet 286,475€.

Të hyrat e realizuara nga komuna në 2020 ishin në vlerë 253,217€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga qiraja etj.

Tabela 3. Të hyrat(në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2020 Pranimet	2019 Pranimet	2018 Pranimet
Të hyrat tatimore	258,140	258,140	138,333	182,928	170,152
Të hyrat jo tatimore	204,204	204,204	114,884	170,579	179251
Totali	462,344	462,344	253,217	353,507	349,402

Totali i të hyrave të arkëtuara reflekton situatën e krijuar gjatë vitit 2020, ku kemi rëni të mbledhjes së të hyrave në raport me vitin e kaluar dhe vitin paraprak. Në këtë vit të hyrat krahasuar me vitin 2019, ishin më të ulëta për 28% apo për 100,290€.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2019 ka rezultuar në 15 rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2020, 9 rekomandime janë zbatuar; 5 nuk kishte filluar zbatimin si dhe një nuk aplikohet më, siç është paraqitur në Grafikon 4, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 4. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2020

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2019	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	PFV	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që kërkesat të planifikohen dhe kategorizohen sipas ndarjes adekuate të buxhetit. Nëse projeksionet e buxhetuara me ligj të buxhetit nuk përkojnë me natyrën e shpenzimit dhe nevojat e komunës, duhet të bëhet ridestinimi i mjeteve me qëllim të sigurimit të fondeve për pagesën e rregullt të shpenzimeve.	Edhe në vitin 2020 kemi identifikuar keq klasifikime të shpenzimeve. Shih B2	Nuk ka filluar zbatimin.
2	Të hyrat	Kryetari i komunës duhet të shtojë kontrollet lidhur me dhënien në shfrytëzim të pronës komunale duke vlerësuar të gjitha kontratat, si dhe duke ndërmarrë masa në arkëtimin e të hyrave të pa inkasuara. Po ashtu, Kryetari duhet të sigurojë së dhënia e këtyre pronave në shfrytëzim bëhet sipas kërkesave të ligjit për shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.	Edhe në këtë vit nuk kemi vërejtur që janë përtrirë kontratat. Shih B1	Nuk ka filluar zbatimin.
3	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë që procesi i vlersimit të ankandëve publike bëhet nga përbërja e plotë e komisionit për vlerësimin e ofertave të pronave të paluajtshme, si dhe me të krijoj kushte që ofertuesit potencial të mos tërhiqen prej konkurrimit.	Nuk kemi vërejtur raste të tilla.	I zbatuar.
4	Të hyrat	Kryetari duhet të vendos kontrolle duke caktuar zyrtar përgjegjës për përcjelljen e rregullave të nivelit qendror, dhe që të njëjtat të jenë të harmonizuar me rregulloret e brendshme komunale, dhe me kohë të iniciohen plotësim/ndryshimet e rregulloreve komunale duke i përcjellur për miratim tek organet relevante	Nuk kemi vërejtur që ka pasur raste të tilla.	I zbatuar.

5	Të hyrat	Kryetari të siguroj se do të zbatohen kërkesat ligjore për depozitimin në llogari bankare me kohë të të hyrave të mbledhura, nëpërmes arkës nga zyrtarët kompetent.	Menaxhmenti kishte filluar depozitimin me kohë të parashë nga arka.	I zbatuar.
6	Paga dhe mëditje	Kryetari të ndërmarr veprimet e duhura në vlerësimin e situatës dhe siguroj që punësimi bëhet duke respektuar kriteret e konkursit.	Në këtë vit nuk janë trajtuar procedurat e rekrutimi sipas metodologjisë së re të auditimit.	Nuk është i aplikueshëm më.
7	Paga dhe mëditje	Kryetari i komunës përmes menaxherit të personelit duhet të sigurohet se stafi i drejtorisë së shëndetësisë kompletojnë dëshmitë për përvojën e punës për të krijuar bazë ligjore për ekzekutimin e shtesës në bazë të përvojës.	Menaxhmenti kishte ndërmarr masa duke nënshkruar vendimet.	I zbatuar.
8	Mallra dhe shërbime	Kryetari duhet të siguroj përmes menaxherit të prokurimit se aplikohet proces i plotë i procedurave të prokurimit në përputhshmëri me kërkesat ligjore në fuqi duke ndërmarr veprimet e nevojshme, tërheqjen e sigurisë së tenderit për ofertuesit jo serioz.	Nuk kemi vërejtur raste të ngjashme.	I zbatuar.
9	Subvencione dhe transfere	Kryetari duhet të siguroj që më rastin e shpalljes/thirrjes publike të vendosen kriteret dhe që më rastin e përzgjedhjes së përfituesve të subvencioneve të shpërblehen vetëm ata të cilët i kanë plotësuar të gjitha kërkesat.	Nuk kemi vërejtur raste të ngjashme.	I zbatuar.
10	Investime kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që hartimi i projekteve ekzekutive të realizohet para inicimit të procedurave të prokurimit.	Nuk kemi vërejtur raste të tilla.	I zbatuar.
11	Investime kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që në procedura të prokurimit, kriteret të vendosen sipas kërkesave ligjore duke vërtetuar përshtatshmërinë e operatorëve ekonomik.	Për këtë, kishte kërkuar në dosje të tenderit vërtetimin e gjykatës.	I zbatuar.

12	Investime kapitale	Kryetari i Komunës duhet të sigurohet që të ndalohet praktika e ndërprerjes së kontratave pa përfillë procedurat dhe kriteret ligjore. Gjithashtu duhet siguruar nivelin e duhur të komunikimit mes departamenteve me qëllim të përmbushjes së objektivave të komunës krahas respektimit të ligjeve.	Në këtë vit nuk kishte shkëputje të njëanshme të kontratave.	I zbatuar.
13	Çështje të përbashkëta	Kryetari duhet të siguroj që bëhet një planifikim i hollësishëm dhe njësitë kërkuese duhet të vlerësojnë në mënyrë të drejtë kërkesat për prokurim.	Edhe këtë vit kemi raste të kontratave me vlerë minimale. Shih B3	Nuk ka filluar zbatim.
14	Pasuritë kapitale dhe jokapitale	Kryetari duhet të siguroj hartimin e rregullave dhe procedurave të brendshme për evidencën, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë jo financiare sipas kërkesës së rregullore 02/2013 dhe kërkesat në lidhje me regjistrimin dhe mirëmbajtjen e pasurive duhet të aplikohen në tërësi, përmes sistemit e-pasuria të evidentohen të gjitha hyrjet/daljet e pasurive të luajtshme (me vlera nën 1,000€) për të gjitha dikasteret komunale.	Edhe këtë vit kemi të njëjtën çështje si vitin e kaluar. Shih B4	Nuk ka filluar zbatim.
15	Te arkëtueshmet	Kryetari duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika, rregullore dhe mekanizma tjerë me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e të arkëtueshmeve. Po ashtu, duhet shqyrtuar të gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj debitorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet.	Edhe në këtë vit kemi rritje të llogarive të arkëtueshme. Shih B5	Nuk ka filluar zbatim.
Nr	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2020		
1	Të hyrat	Kryetari duhet të shtojë kontrollet lidhur me dhënien në shfrytëzim të pronës komunale duke vlerësuar të gjitha kontrata. Njëherit të sigurojë së dhënia e këtyre pronave në shfrytëzim bëhet sipas kërkesave të ligjit për shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.		

2	Mallrat dhe shërbimet	Kryetari duhet të sigurohet që pranimin i mallrave përkatësisht drunjëve bëhet sipas kushteve të kontratës dhe që asnjë pagesë të mos bëhet nëse pranimet nuk janë të nënshkruara nga tre anëtar të komisionit.
3	Mallrat dhe shërbimet	Kryetari duhet të siguroj se kërkesat dhe furnizimet bëhen vetëm pasi të jenë zotuar mjetet duke eliminuar hyrjen në obligime të paplanifikuara.
4	Mallrat dhe shërbimet	Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë veprimet e nevojshme në mënyrë që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV në përputhje me planin kontabël.
5	Çështjet e përbashkëta	Kryetari duhet të siguroj që bëhet një planifikim i hollësishëm dhe njësitë kërkuese duhet të vlerësojnë në mënyrë të drejtë kërkesat për prokurim.
6	Pasuria kapitale dhe jokatitale	Kryetari duhet të siguroj se kërkesat në lidhje me regjistrimin dhe mirëmbajtjen e pasurive duhet të aplikohen në tërësi, përmes sistemit e pasuria të evidentohen të gjitha hyrjet/daljet e pasurive të luajtshme (me vlera nën 1,000€) për të gjitha dikasteret komunale.
7	Të arkëtueshmet	Kryetari duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika, rregullore dhe mekanizma tjerë me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e të arkëtueshmeve. Po ashtu, duhet shqyrtuar të gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj debitorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet.

Nënshkrimet:

Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm

Astrit Bllaca, Udhëheqës i Auditimit

Etika Co shpk, (Fatmir Mehmeti person i autorizuar në emër të kompanisë)

Shtojca I: Letër konfirmimi



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2020 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Dragashit , për vitin 2020 (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Kryetari i Komunës së Dragashit

Shaban Shabani

Data: 29 qershor, 2021, Dragash

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragash

02 Nr. Br. 400/21-12181/21

29.06.2021

Dragash - Dragash

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesët e tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁷ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁸. Ky opinion duhet të veçohet nga opinionin nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërteta, d.m.th. opinionin mund të modifikohet në lidhje me çështje (-t) e pajtueshmërisë, por mund të mos modifikohet - në lidhje me besueshmërinë e pasqyrave financiare (ose anasjelltas).

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose jo i modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me) të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Një keq-deklarim është një ndryshim midis shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një artikulli të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që artikulli të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinionin i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, ose janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, një e vetme ose e agreguar, që nuk është e barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare në tërësi ose keq-deklarimi (-et) dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar të transaksioneve nuk është e barabartë ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të çojë në shmangie të keq-deklarimit (-eve) material (-e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(-ve).

⁷ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë poashtu edhe deklaratat e ekzekutimit të buxhetit

⁸ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë prova të mjaftueshme të auditimit për të konkluduar se pasqyrat financiare në tërësi janë të lira nga keq-deklarimi material.

Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Ndryshimet e opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në provat e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk janë të lira nga keq-deklarimi material dhe/ose mos-pajtueshmëria ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit të mjaftueshëm për të konkluduar se pasqyrat financiare në tërësi janë të lira nga keq-deklarimi material dhe/ose mos-pajtueshmëria, auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit.

Opinionet e modifikuara mund të jenë:

- Të modifikuara (kualifikuara)
- Të kundërta, ose
- Të mohuara

Opinion i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos pajtueshmëri, një e vetme ose një agregat, që është e barabartë ose e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si një e tërë ose kur keq-deklarimi (-et) dhe / ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klasë të caktuar të transaksioneve është i barabartë ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit që nuk mund të çojë në shmangie të keq-deklarimit(-eve) material (-e).

Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, një e vetme ose një agregat, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si një e tërë ose kur keq-deklarimi (-et) dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klasë të caktuar të transaksioneve e tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret në kontekstin e gabimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive për të përshkruar efektet e gabimeve dhe/ose mos-pajtueshmërinë në pasqyrat financiare ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të gabimeve dhe/ose mos-pajtueshmërinë,

nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë prova të mjaftueshme adekuate të auditimit. Efektet të përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit:

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare
- b) Nëse kufizohen kështu, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Në lidhje me shpalosjet, janë thelbësore për kuptimin e pasqyrave financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe e përhapur.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.